

PROPOZICIONET E GARAVE PËR KUPËN E KOSOVËS PËR VITIN GARUES 2008/09

Neni 1

Me këto propozicione përcaktohen dispozitat mbi organizimin dhe zhvillimin e garave për Kupën e Kosovës (në tekstin e mëtejme - Garat për Kupë).

Me këto dispozita përcaktohet sistemi i garave për Kupë. Rregullorja e garave, kalendari, shpenzimet e garave, mënyra e paraqitjes, tërheqja e shortit, ankesat dhe gjithë ato veprime që do të bëhen në lidhje me garat për Kupë.

Neni 2

Federata e Basketbollit e Kosovës është organizatore e garave për Kupë, në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave.

Me gara udhëheq Komisari i garave .

Neni 3

Skuadrave fituese të finales së Kupës u jepen kupat dhe medaljet.

Neni 4

Garat për Kupë udhëhiqen në bazë të dispozitave të Rregullores mbi organizimin e garave të basketbollit, propozicionet e garave për Kupë dhe me rregulloret e tjera të FBK-së.

Neni 5

Në garat për Kupë në mënyrë obligative marrin pjesë ekipet që bëjnë gara në Ligën cilësore (Super liga) dhe Liga e parë dhe Liga e dytë për meshkuj si dhe Liga e parë për femra.

Pjesëmarrës i garave të Kupës së Kosovës është çdo ekip që vepron dhe është nga territori i Kosovës.

Neni 6

Paraqitja e ekipeve dhe tërheqja e shortit bëhet më së paku 10 ditë para fillimit të garave, fillimin e të cilave e cakton Komisari i garave dhe e verifikon Bordi i FBK-së.

Neni 7

Të drejtën e paraqitjes në ndeshjet në garat për Kupë e gëzojnë të gjithë lojtarët-lojtaret e regjistruar-a në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve për vitin garues 2008-2009

Lojtari i cili regjistrohet në afatin e rregullt kalimtar veror apo mini afatin dimëror dhe në afatet e jashtëzakonshme të parapara me vendimin e Bordit të FBK ka të drejtë paraqitje

pa marr parasysh se a ka zhvilluar ndeshje për ndonjë ekip tjetër gjatë edicionit të Kupës së Kosovës 2008/09.

Nëse për ndonjërin ekip paraqitet lojtari-ja që më parë nuk është regjistruar, ekipi i tij e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0.

Neni 8

Garat për Kupë zhvillohen në sistem të mënjanimi (eliminimit). Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas rregullave ndërkombëtare të lojës së basketbollit.

Neni 9

Të gjitha skuadrat e meshkujve ndahen në katër grupe. Bartës të grupeve janë skuadrat më të suksesshëm në pjesën e parë të Kampionatit aktual.

Në xhiron e parë vendas janë skuadrat që kanë plasman më të mirë në pjesën e parë të kampionateve.

Në xhiron e dytë vendas janë ekipet që në ndeshjet para kanë qenë mysafirë. Nëse të dy ekipet rivale në xhiron e parë kanë qenë vendas apo mysafirë, vendasi caktohet me short.

Fituesit e grupeve plasohen në fajnal-four. Çiftet gjysmëfinale caktohen me short.

Skuadrat e femrave ndahen në dy grupe. Fituesit e grupeve plasohen në finale.

Neni 10

Për kohën dhe vendin e zhvillimit të lojës vendësit janë të obliguar të lajmërojnë Komisararin e garave, ekipin mysafir, vëzhgues-kontrolluesin, gjyqtarët së paku 48 orë para zhvillimit të ndeshjes.

Mos përmbushja e këtij obligimi sanksionohet me përgjegjësitë e Rregullores disiplinore dhe dënimin me gjobë prej 100 €

Neni 11

Në ndeshjet gjysmëfinale dhe finale për meshkuj dhe finale për shpenzimet e personave zyrtarë dhe shpenzimet e tjera barten nga organizatori i ndeshjeve finale. Të hyrat nga biletat e shitura, reklamat, transmetimet në TV etj, i takojnë organizatorit.

Neni 12

Detyrat e vëzhgues-kontrolluesit dhe të gjyqtarëve janë të njëjta si në ndeshjet kampionale.

Neni 13

Ankesat për garat për Kupë duhet të paralajmërohen më së voni 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes.

Arsyetimi i ankesës duhet të dërgohet Komisararit më së largu 24 orë pas përfundimit të

ndeshjes.

Ankesës në ndeshjen për Kupë duhet t'i bashkëngjitet edhe shuma e mjeteve të paguara Sipas Propozicioneve të garave të FBK.

Kjo shumë e mjeteve i paguhet vëzhgues-kontrolluesit menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, ndërsa vëzhgues-kontrolluesit janë të obliguar që këtë ta shënojnë në protokollin e ndeshjes dhe të konstatojnë se është paraqitur ankesa dhe janë përmbushur obligimet konform al. 2 të këtij neni.

Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej njëzetekatër (24)orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim.

Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë – Komisionit Arbitrar në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve, i cili vendim do të merret në afat prej njëzetekatër (24) orëve.

Vendimi mbi ankesën në ndeshjen gjysmëfinale, në shkallën e parë merret në afat prej katër(4)orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë-KA, i cili vendim do të merret në afat prej tetë(8) orëve.

Neni 14

Nëse ekipi nuk paraqitet fare në ndeshje, ai do të dënohet me 150 € dhe do të eliminohet nga garat e mëtutjeshme si dhe kompensimin e shpenzimeve të skuadrës rivale.

Neni 15

Ndeshjet gjysmëfinale të meshkujve dhe ndeshjet finale të Kupës së Kosovës në dy konkurrencat zhvillohen në vendin që e cakton Bordi i FBK.

Neni 16

Organizimin e ndeshjeve finale, Bordi i FBK-së mund t'ia besojë edhe ndonjërit prej klubeve apo agjencive të specializuara nën kushtet që do të parashtrijë paraprakisht Bordi dhe për këtë do të lidhet kontratë ndërmjet Bordit të FBK-së dhe organizatorit.

Kushtet për fitimin e të drejtës së organizimit të Kupës i përcakton Bordi i FBK.

Neni 17

Çështjet të cilat nuk janë përfshirë me këto Propozicione, do të rregullohen sipas Propozicioneve të garave si dhe akteve tjera normative të FBK-së.

Neni 18

Interpretimin e këtyre propozicioneve e bënë Bordi i FBK-së.

Sekretari i Përgjithshëm i FBK
Isuf Lumi

Kryetari i FBK
Erolld Belegu